

Universi në xhepin tim



Hëna



Julieta Fierro
Instituti i Astronomisë,
UNAM, Meksikë
Grażyna Stasińska

Observatori i Parisit



Fazat e Hënës janë formate ndryshme të pjesëvet të sajtë ndriçuara, parë nga Toka. Vini reqëne shohimtë njejtën faqe të Hënës.

Pamje e fazave të Hënës.

Ju mund të bëni një eksperiment në shtëpi për të kuptuar fazat e Hënës (shihni faqet 15 dhe 16).

Drapëri i Hënës ka pjerrësi të ndryshme, në varësi të pozicionit më afër polit (Veri ose Jug) apo ekuatorit tokësor.



Pranë polit të Veriut (gjerësia $+51^\circ$):
Drapëri i Hënës në Isle of Wight (Mbretëria e Bashkuar)

Burimi: Ainsley Bennett

Pranë ekuatorit (gjerësia -23°)
Drapëri i Hënës në São Paulo (Brazil)

Burimi: Ricardo Motti

Fazat e Hënës

A e keni vënë re se Hëna gjatë një muajë e ndryshon pamjen e saj? Nganjëherë duket errumbullt si top, enganjëherë si buzë e qeshur.

Të gjithë planetet dhe satelitët në Sistemin Diellor kanë anën e tyre të natës dhe anën e ditës.

Nga Toka ne shohim copa të ditëve dhe netëve hënore, si dhe vijën e tyre të ndarjes. Kur forma e Hënës duket rrumbullake, kjo ndodh se e ka Diellin përballë. Përndryshe, kur e shohim përgjysëm të ndriçuar, kjo ndodh se Dielli ndodhet anash saj.

Nga Toka ne shohim gjithmonë të njejtën faqe të Hënës, sepse rrotullimi i saj rreth vetes dhe sjellja e saj rrotull Tokës janë të sinkronizuara. Ana e mbrapme e Hënës është fotografuar për herë të parë në 1959 nga një sondë Sovjetike.

Ngjyra e Hënës

Hëna ndriçon sepse reflekton dritën e Diellit. Zonat e saj ngjyrë gri janë lava të ngurtësuara. Shkëmbinjtë e Hënës të sjellë nga astronautët i ngjajnë lavave vulkanike. Pjesët më të ngritura të Hënës janë më të ndritshme; ato janë të pasura me kalçium dhe alumin, dhe e reflektojnë më fort dritën e Diellit.

Kur Hëna ndodhet pranë horizontit, duket e portokalltë - dhe akoma më e portokalltë gjatë eklipseve hënore. Kjo ndodh sepse pluhurat në atmosferën tonë shpërhapin dritën blu dhe të gjelbër të Diellit e lënë të kalojë vetëm të verdhën, portokallinë dhe të kuqen.

Gjatë eklipseve, Hëna kalon nëpër hijen e Tokës. Drita e Diellit depërton fillimisht nëpër atmosferën e Tokës përtë rënë në Hënë, e më pas drita e reflektuar kalon për herë të dytë nëpër atmosferë përtë ardhur te ne.



Zonat gri të Hënës janë lava të ngurtësuara. Zonat më të larta janë më të ndritshme, ngaqë janë të pasura në kalçium dhe alumin.



Shkëmbinjtë e errët të Hënës ngjajnë me shkëmbinjtë tokësorë vulkanikë.

Burimi NASA

Pluhuri në atmosferën tonë shpërhap dritën blu dhe të gjelbër dhe lë të kalojë dritën e kuqe dhe portokalli. Hëna ngjan portokalli pranë horizontit, për arsy se atmosfera në të cilën drita e reflektuar e Diellit kalon



Credit NASA

ka trashësi më të madhe se kur Hëna ndodhet lart.



Credit NASA

Gjatë eklipseve hënore, Hëna merr ngjyrë portokalli të errët.



I njejti objekt duket më i madh ose më i vogël në varësi të madhësisë së objekteve të afërta.

Në figurën më sipër rrathët portokall kanë të njejtin diametër.

Djathtas, imazhet e Hënës kanë të njejtin diametër.

Kur shohim Hënën sipër rrugëve të ngushta, ajo duket më e madhe. Ky është iluzion optik.



© Sky and Telescope



"Duke luajtur me topin qiellor" - Foto e marrë nga Laurent Laveder që tregon Hënën kur është pranë horizontit.



Toka dhe Hëna në të njejtin shkallëzim.

Brenda Tokës mund të hynin 50 Hëna.

Madhësia e Hënës

Me siguri keni vënë re se Hëna duket më e madhe kur është pranë horizontit se sa kur është lart. Ky efekt quhet "iluzioni i Hënës" dhe njihet që nga kohët e vjetra.

Rruga për të përceptuar madhësinë e një objekti varet nga mjedisit i dukshëm që e rrethon. Kur Hëna është pranë horizontit, objektet pranë saj shihen në detaje, prandaj ajo duket e madhe. Kur Hëna është në zenit, rrethohet nga zona të gjera qelli bosh, që e bëjnë të duket më e vogël.

Rreth 2200 vite më parë, grekët e vjetër e llogaritën rrezen e Hënës (shih TUIMP 15). Matjet e sotme japin vlerën 1737 km, që është afro sa çereku i rrezes së Tokës.



Credit: SëRI

Paraqitje artistike e përplasjes së Tokës me një planet të sapoformuar, të quajtur Theia.

Hëna mendohet të jetë formuar fill mbas formimit të Tokës.




Diagrama e formimit të Hënës.

Burimi: Wikipedia

Foto e Hënës, marrë në 21 Janar 2019.



Shigjeta tregon vendndodhjen e një flashi drite, të shkaktuar nga një meteoroid që goditi sipërfaqen në atë ditë.

Burimi: J.M. Madiedo

Origjina e Hënës

Hëna është më e re se Toka dhe përbërja e saj kimike i ngjan shkëmbinje të Marsit, më shumë se atyre të Tokës. Mendohet të jetë formuar kur një planet i sapokrijuar (i quajtur Theia, sipas emrit të nënës së Selenës, perëndisë greke të Hënës) u përplas me Tokën. Si rezultat i përplasjes, materiali u shpërnda në të gjitha drejtimet; një pjesë iku në hapësirë dhe një pjesë e tij formoi një disk rrotull planetit tonë. Materiali në disk u ngjit dhe formoi Hënën.

Gradualisht Hëna u ftoh, por brendësia mbeti ende e shkrirë, dhe lava rroddhi në sipërfaqe, duke krijuar zonat e errëta.

Gjatë 600 milionë viteve të saj të para, Hëna u bombardua nga asteroide dhe kometa, të cilat formuan kratere që shihen edhe sot.

Graviteti në Hënë


Nëse keni parë foto apo video të astronautëve që ecin mbi Hënë, do të keni vënë re me siguri që ata nuk "ecin" por "kërcejnë". Kjo ndodh se tërheqja gravitacionale e Hënës është shumë më e vogël se e Tokës.

Një fëmijë që peshon 30 kg në Tokë do të peshonte 5 kg në Hënë, sepse forca e gravitetit që vepron mbi të do të ishte 6 herë më e vogël!

Meqë Hëna ka gravitet kaq të dobët, ajo nuk i mban dot molekulat e gazit. Prandaj Hëna nuk ka atmosferë.

Asteroidet dhe meteoroidet që godasin Hënën krijojnë kratere.

Meqë nuk ka atmosferë, nuk ka erëra që t'i fshijnë pluhurat e as ujra që t'i shkatërrojnë krateret, siç ndodh në Tokë.



Astronauti Eugene Cernan duke kërcyer mbi hënë (NASA, 1972).

Mbi 2 milionë kratere me diametra më të mëdhenj se 1 km janë identifikuar mbi sipërfaqen e Hënës. Figura tregon një pamje të polit jugor të Hënës.

(NASA/JPL/USGS)

Transporti i gjithçkaje të nevojshme për të mbajtur misione afatgjata në Hënë do të ishte shumë i shtrenjtë. Një zgjidhje më e mirë do të ishte që nevojat të plotësohen duke përdorur materialet hënore.



Prototip baze hënore (ESA)

Guacka, e ndërtuar nga trualli hënор, prej robotëve me printerë 3D, do të mbronte astronautët nga meteoroidet, rrezatimi gama dhe ndryshimet e temperaturës.

Për të prodhuar ushqimin e astronautëve, grupe të ndryshme kërkimore po testojnë mënyrat për të rritur bimë duke përdorur truallin hënор, të përzier me bakterie dhe fertilizues.
(Open Agriculture, 2019)



Stacionet e ardhshme mbi Hënë


Në Hënë ka pak ujë. Në fund të kratereve dhe çarjeve pranë poleve ku nuk bie drita e Diellit, uji është ingrirë. Në të ardhmen do të përdoren robotë për të transportuar këtë ujë në sera, ku bimët jo vetëm që do të prodhojnë ushqim të freskët, por edhe do të krijojnë oksigjen për frymëmarrje dhe përlëndë djegëse.

Kur astronomët e parë u dërguan në Hënë, veshjet e tyre hapësinore ishin mbuluar me një pluhur shumë të hollë ngjitës, të vështirë përt'ua pastruar. Astronautët përdorën furça, që e shpërndanë një pjesë të pluhurit, dhe ky u shkaktoi probleme në frymëmarrje dhe në sy. Eksploruesit e ardhshëm do të marrin me vete pastrues me vakum përveshjet e tyre. Pluhuri hënор do të përdoret përtë rritur bimë në serat hënore dhe përtë prodhuar paisje me printerë 3D.

Një eksperiment për të kuptuar fazat e Hënës

Instruksionet në faqen tjeter

burimi: JPL



Ndizni një poç në një dhomë të errët. Merrni një top ping-pongu, shpojini një vrime me laps dhe mbajeni lapsin vertikalisht me topin sipër.

Poçi është Dielli, topi është Hëna dhe ju jeni Toka.

Rrini përballë dritës dhe mbajeni topin përpara, duke e ngritur aq lart sa mund ta shihni edhe poçin. Ai ndriçon anën e prapme të Hënës. Kjo fazë quhet **hëna e re**.

Nga Toka, hëna e re nuk është e dukshme.

Kthehuni majtas që hëna juaj dhe trupi tëjenë pingul me pozicionin e parë. Tani do të ndriçohet gjysma e djathtë e topit. Kjo fazë quhet **çereku i parë**.

Bëni edhe një çerek rrotullimi majtas. Tani hëna juaj është direkt kundër Diellit, parë nga Toka. Gjysma që shihet është krejt e ndriçuar. Kjo është **hëna e re**.

Bëni edhe një çerek rrotullimi majtas. Ana e kundërt e çerekut të parë tani është e ndriçuar. Ky është **çereku i fundit**.

Universi në xhepin tim No. 27

Ky minilibër u shkrua në 2022 nga Julieta Fierro e Institutit të Astronomisë, UNAM, Meksikë dhe Grażyna Stasińska e Observatorit të Parisit dhe u rishikua nga Stan Kurtz i Instituti i Astronomisë në Morelia UNAM (Meksikë).

Pamja e kapakut: Hëna në një qiel me yje e pasqyruar mbi det. Elemente të kësaj pamjeje janë marrë nga NASA. Burimi: Vovan (Ukraine)



Përtë mësuar më shumë mbi këtë koleksion dhe temat e prezantuara në këtë minilibër vizitoni <http://www.tuimp.org>.